

**L I G J**  
**Nr.8737, datë 12.2.2001**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E**  
**SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008)*

*I azhurnuar*

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1, 148 dhe 149 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**K R E U I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është:

- a) përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë;
- b) kushtet që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen prokurorë;
- c) statusi i prokurorit;
- ç) karriera dhe procedimi disiplinor i prokurorit;
- d) marrëdhëniet e Prokurorisë me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun.

Neni 2  
**Objekti i veprimtarisë së Prokurorisë**

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.
2. Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve.

Neni 3  
**Struktura e Prokurorisë**

Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë dhe prokuroritë pranë sistemit gjyqësor.

Neni 3/a  
**Organet e prokurorisë dhe përfaqësimi i saj**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 1)*

1. Organet e prokurorisë janë:
  - a) Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
  - b) prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
  - c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit; ç) prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda;
  - d) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.
2. Përfaqësimi i prokurorisë bëhet nga:
  - a) Prokurori i Përgjithshëm;
  - b) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit;
  - c) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

Neni 3/b

### **Shkalla e hierarkisë në prokurori**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 1)*

1. Shkalla e hierarkisë në prokurori, sipas niveleve të organizimit dhe të funksionimit në drejtimin e centralizuar, nga prokurori më i lartë te prokurori më i ulët, është si më poshtë:
  - a) prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme janë prokurorë më të lartë se prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë;
  - b) prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, në gjykimet e çështjeve të apeluara që kanë në juridiksion, janë prokurorë më të lartë se prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të cilët i përkasin atij juridiksioni;
  - c) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë, sipas kompetencës, lëndore dhe tokësore, janë prokurorë të nivelit të parë në prokurori.
2. Prokurorët, drejtues të drejtorive në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtues të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe drejtues të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, janë prokurorë më të lartë se prokurorët në strukturat përkatëse, ku ata ushtrojnë funksionet.

Neni 3/c

### **Kufizimet e pushtetit të prokurorit më të lartë**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 1)*

1. Prokurori, në çdo rast të mbështetur në ligj dhe në prova, refuzon përmbushjen e urdhrimit ose të udhëzimit, që është haptazi në kundërshtim me ligjin.
2. Refuzimi bëhet me akt të shkruar, në të cilin prokurori arsyeton shkaqet e refuzimit.
3. Në rast refuzimi, drejtuesi i prokurorisë ose prokurori më i lartë, që ka dhënë urdhrin ose udhëzimin, ka të drejtë të zëvendësojë prokurorin, që refuzon, duke proceduar personalisht ose duke ia ngarkuar ushtrimin e ndjekjes penale një prokurori tjetër.
4. Me përjashtim të rasteve haptazi në kundërshtim me ligjin, nuk përbëjnë objekt refuzimi:
  - a) vendimet e marra në rrugë hierarkike, në zbatim të ligjit procedural penal;
  - b) urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 3/ç

### **Shmangia e konfliktit të interesit**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 1)*

1. Drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor, drejtuesit të prokurorisë pranë gjykatës së apelit, prokurorit të apelit, prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme apo Prokurorit të Përgjithshëm, kur gjendet në një çështje penale në rastet e parashikuara në nenet 16 e 17 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, i ndalohet t'i japë urdhra dhe udhëzime, me shkrim, prokurorit të çështjes apo të ndikojë në çdo mënyrë tjetër.

2. Në këtë rast drejtuesi në konflikt interesi njofton, me shkrim, Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm, kryesisht ose me kërkesë, vendos me shkrim për përjashtimin e drejtuesit në konflikt interesi nga procedura e dhënies së urdhrave dhe udhëzimeve. Në këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm cakton nëse dhe në ç'pjesë kanë vlerë veprimet e kryera në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna më parë nga drejtuesi në konflikt interesi.

3. Në rastin kur Prokurorit të Përgjithshëm i kërkohet nxjerrja e një urdhri apo dhënia e një udhëzimi në një procedim, në të cilin ai është në konflikt interesi, atëherë ai deklaron, me shkrim, gjendjen e konfliktit të interesit dhe njofton prokurorin, që i ka kërkuar nxjerrjen e urdhrat apo dhënien e udhëzimit. Në këtë rast, urdhri apo udhëzimi nxirret nga prokurori më i vjetër në detyrë, drejtor në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 3/d

### **Drejtimi në prokurori**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 1)*

1. Prokurori i Përgjithshëm drejton organin e prokurorisë dhe ndihmohet nga drejtuesit e strukturave në Prokurorinë e Përgjithshme.

2. Prokuroritë pranë gjykatave të apeleve drejtohen nga drejtuesi i prokurorisë së apelit, i ndihmuar nga zëvendësi i tij.

3. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë drejtohen nga drejtuesi i prokurorisë, i ndihmuar nga zëvendësit dhe përgjegjësit e sektorëve, aty ku ka të tillë.”.

Neni 4

### **Ligjshmëria e veprimtarisë**

*(Shtuar pika 3 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 1)*

*(Shtesë në pikën 3, shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 3 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 2)*

1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut.

3. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë jepen me shkrim të arsyetuara dhe janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

4. Prokurorët marrin masa për ushtrimin e ndjekjes penale, zbatimin e udhëzimeve që jepen në përputhje me ligjin, të vendimeve penale dhe të urdhrave të gjykatës, si dhe ndihmojnë në miradministrimin e drejtësisë.

Neni 5

### **Veprimtaritë parandaluese**

Prokuroria organizon dhe/ose bashkëpunon me institucione shtetërore, si dhe me subjekte të tjera publike e private për veprimtari për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit.

Neni 6

### **Marrëdhëniet me publikun**

1. Prokuroria vë në dijeni opinionin publik për veprimtarinë që kryen.

2. Prokurorisë nuk i lejohet të japë të dhëna që dëmtojnë procesin e hetimeve, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, që cenojnë të drejtat e të miturve dhe moralin publik.

KREU II  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM  
Neni 7

**Emërimi dhe shkarkimi**

*(Shtuar pikat 1/1, 1/2 e 1/3 me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 3)*

1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

1/1. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve me përvojë pune jo më pak se 10 vjet në sistemin e drejtësisë dhe shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale.

1/2. Prokurori i Përgjithshëm qëndron në detyrë për 5 vjet, me të drejtë riemërimi.

1/3. Pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, ai ka të drejtë të emërohet në funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme ose në vendin e mëparshëm apo në një vend të barasvlefshëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të Kushtetutës, për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kuvendit për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve, për paaftësi mendore a fizike, për akte sjelljeje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.

Neni 8

**Kompetencat**

*(Ndryshuar titulli, pika "1" dhe "3" me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 2)*

*(Ndryshuar pika 2, shfuqizuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 4)*

1. Prokurori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, në emër të shtetit, si dhe për realizimin e detyrave të tjera që, me ligj, i ngarkohen Prokurorisë.

2. Prokurori i Përgjithshëm ka këto detyra kryesore:

a) përfaqëson prokurorinë në kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese;

b) i propozon Presidentit të Republikës numrin e përgjithshëm të prokurorëve, pasi të ketë marrë mendimin e Ministrit të Drejtësisë, si dhe përcakton numrin e prokurorëve, për çdo prokurori, përfshirë edhe Prokurorinë e Përgjithshme;

c) i propozon Presidentit të Republikës emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, largimin nga detyra dhe shkarkimin e prokurorëve;

ç) cakton drejtuesit e prokurorive dhe zëvendësit e tyre në prokuroritë pranë gjykatave, sipas kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara në këtë ligj;

d) miraton strukturën, organikën dhe rregulloret e funksionimit të prokurorive pranë gjykatave dhe të Prokurorisë së Përgjithshme;

dh) urdhëron komandimin e prokurorëve, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj;

e) emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kancelarët e prokurorive;

ë) përfaqëson prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët, në nivel qendror;

f) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;

g) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e prokurorisë dhe të policisë gjyqësore;

gj) nxjerr akte normative (rregullore, urdhra dhe udhëzime), për ushtrimin e detyrave të përcaktuara nga ky ligj ose nga ligje të veçanta, të cilat janë të detyrueshme për prokurorët dhe policinë gjyqësore;

h) urdhëron kryerjen e inspektimeve, fillon procedimin disiplinor dhe vendos për marrjen e masave disiplinore, si dhe urdhëron fillimin e procedimit penal kundër prokurorëve;

i) fillon procedimin disiplinor dhe urdhëron procedimin penal të policisë gjyqësore, në përputhje me ligjin e veçantë;

j) mbikëqyr drejtpërdrejt shërbimin e inspektimit të prokurorisë dhe miraton planin vjetor të inspektimeve të përgjithshme në prokurori;

k) thërret mbledhjen e këshillit të prokurorisë dhe mund të drejtojë mbledhjet e tij;

l) i delegon me shkrim kompetenca drejtorëve, përgjegjësve të sektorëve ose prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas parashikimeve në këtë ligj ose në ligje të veçanta, me përjashtim të atyre që parashikojnë shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “gj”, “h” dhe “i” të kësaj pike;

ll) i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë;

m) kryen detyra të tjera, të parashikuara në ligj.

2. Prokurori i Përgjithshëm nxjerr urdhra dhe udhëzime për ushtrimin e detyrave të përcaktuara nga ky ligj ose nga ligje të veçanta.

3. Shfuqizuar.

4. Shfuqizuar.

### KREU III ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 9

#### **Struktura**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 3)*

*(Shtuar shkronja ç e pikës 1 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 5)*

1. Struktura e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm përbëhet nga:

a) kabineti;

b) drejtoritë;

c) sektorët;

ç) zyra e ndihmësve ligjorë.

2. Struktura, organizimi dhe përcaktimi i hollësishëm i funksioneve të hallkave të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm bëhen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm funksionojnë shërbimet e ekspertimeve, organizimi dhe funksionimi i të cilave përcaktohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

### KREU IV KËSHILLI I PROKURORISË

Neni 10

#### **Kompetencat**

*(Ndryshuar pika “1” me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 4)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 6)*

1. Këshilli i prokurorisë kryen funksione këshillimore, në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Mendimet e këshillit të prokurorisë paraqiten në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruhen nga kryetari. Aktit i bashkëlidhet, detyrimisht, edhe mendimi i anëtarëve në pakicë.

3. Këshilli i prokurorisë ushtron këto kompetenca:

a) organizon konkursin për emërimin e kandidatëve për prokuror dhe i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e prokurorëve në detyrë, shkarkimin e tyre, si dhe çdo nismë tjetër me natyrë disiplinore;

b) shqyrton vlerësimin e punës së prokurorëve dhe i paraqet, për miratim, Prokurorit të Përgjithshëm raportin e vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale të prokurorëve;

c) i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm për ngritjen në detyrë të prokurorëve, transferimin (lëvizje paralele ose ndryshime të ngjashme), si dhe kandidaturat e drejtuesve të prokurorive dhe zëvendësimit të tyre, duke paraqitur mendimin e tij për kandidatët pas procedurës së konkurrimit të tyre;

ç) jep mendim për miratimin, nga Prokurori i Përgjithshëm, të rregullores së këshillit të prokurorisë;

d) jep mendim për planin vjetor të inspektimeve dhe tematikën e tyre;

dh) merr në shqyrtim dhe jep mendim për vlerësimet e Ministrit të Drejtësisë lidhur me inspektimet e kryera në organe të prokurorisë;

e) jep mendim për projekt-aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm, për unifikimin e politikës së ndjekjes penale, në hetim dhe në gjykim, si dhe propozon masa për organizimin e brendshëm dhe miradministrimin e prokurorisë apo përmirësimin e legjislacionit në fushën penale;

ë) kryen çdo detyrë tjetër, të caktuar me ligj.

4. Këshilli i prokurorisë shqyrton ankesat për vlerësimin e prokurorëve dhe mund të refuzojë ose ka të drejtë të fillojë rishikimin e vlerësimit, që nuk është pranuar nga prokurori përkatës, sipas rregullave të përcaktuara nga Prokurori i Përgjithshëm.

5. Në rastet kur Prokurori i Përgjithshëm nuk është dakord me mendimet e sugjeruara nga këshilli, vendimmarrjen e tij ndryshe e parashtron të arsyetuar.

Neni 11

### **Përbërja**

*(Ndryshuar pika 1, shtuar paragrafi i dytë i pikës 2 me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008, neni 7)*

1. Këshilli i prokurorisë përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët gjashtë prokurorë dhe një përfaqësues i Ministrit të Drejtësisë. Në mbledhjen e këshillit mund të marrë pjesë edhe një përfaqësues i Presidentit të Republikës.

2. Prokurorët, anëtarë të Këshillit të Prokurorisë, duhet të kenë mbi pesë vjet pune si prokurorë. Ata zgjidhen çdo tre vjet nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve. Kandidaturat paraqiten nga një grup me jo më pak se 10 prokurorë dhe votimi bëhet i fshehtë. Mbledhja drejtohet nga Prokurori i Përgjithshëm.

Përbërja e këshillit duhet të jetë si më poshtë:

a) tre prokurorë, që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;

b) dy prokurorë, që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve;

c) një prokuror, që ushtron funksionet në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Në Këshillin e Prokurorisë nuk mund të zgjidhen ose të jenë anëtarë prokurorët, ndaj të cilëve është dhënë ose jepet masë disiplinore.

Neni 12

### **Rregullat e funksionimit**

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë caktohen nga Prokurori i Përgjithshëm pasi të ketë marrë mendimin e këtij Këshilli.

KREU V

STRUKTURA E PROKURORISË PRANË SISTEMIT GJYQËSOR

Neni 13

**Prokurorët pranë Gjykatës së Lartë**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 5)*

1. Pranë Gjykatës së Lartë funksionet e Prokurorisë ushtrohen nga prokurorët e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Prokurorët pranë Gjykatës së Lartë ushtrojnë ndjekjen penale, si dhe përfaqësojnë akuzën në gjyq kundër Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Neni 14

**Prokurorët pranë gjyqtarëve të apelit**

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate apeli ushtrohen nga prokurorët e apelit. Juridiksioni i tyre shtrihet në të gjithë territorin, ku shtrihet juridiksioni i gjykatës përkatëse.

Neni 15

**Prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë**

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate të shkallës së parë ushtrohen nga prokurorët e shkallës së parë. Juridiksioni i tyre shtrihet në të gjithë territorin ku shtrihet juridiksioni i gjykatës përkatëse.

Neni 16

**Ushtrimi i detyrës në një shkallë më të ulët**

Me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori më i lartë zhvillon hetime dhe përfaqëson akuzën si prokuror i shkallëve më të ulëta.

**KREU VI**

**EMËRIMI I PROKURORIT**

Neni 17

**Kushte të përgjithshme**

*(Shtuar shkronja "ë" me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 8)*

Emërohet prokuror në njërin nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, personi që plotëson këto kushte:

- a) është shtetas shqiptar;
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- c) ka arsim të lartë juridik;
- ç) ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- d) nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- dh) nuk është larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike brenda një afati prej tre vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës; kur shkelja disiplinore është kryer gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, prokuror, oficer i policisë, noter ose avokat, afati është pesë vjet;
- e) është jo më pak se 25 vjeç;
- ë) ka cilësi të larta morale dhe profesionale.

Neni 18

**Kushte të veçanta**

*(Ndryshuar shkronja "b, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 9)*

Mund të emërohet prokuror edhe personi që nuk ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, nëse përmbush kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji dhe njërin prej kushteve të mëposhtme:

- a) ka punuar gjyqtar ose prokuror;
- b) ka punuar jo më pak se 5 vjet oficer i policisë gjyqësore.

Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës mund të emërojë në prokuroritë e shkallës së parë, deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të prokurorëve, shtetas, të cilët kanë punuar më parë prokurorë, gjyqtarë apo oficerë të policisë gjyqësore, që përmbushin kriteret e shkronjave "a", "b", "c", "d", "dh", "e" dhe "ë" të nenit 17 dhe të shkronjës "b" të këtij neni.

Neni 19

#### **Kufizime të emërimit**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 6)*

Neni 20

#### **Konkurrimi**

*(Ndryshuar pikat "1" dhe "2" me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 7)*

1. Prokurori i Përgjithshëm shpall publikisht vendet vakant për prokurorë, së paku një muaj para datës së caktuar për zhvillimin e konkurrimit. Shpallja bëhet të paktën në dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe tirazh të mjaftueshëm, si dhe në Radio Televizionin Publik.

2. Depozitimi i kërkesave, të shoqëruara me dokumentet e kërkuara për pranimin në konkurrim, duhet të bëhet nga konkurruesit jo më vonë se dy javë nga data e shpalljes publike të vendit vakant.

3. Këshilli i Prokurorisë bën vlerësimin e kandidaturave dhe mendimin e tij ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, i cili duhet të shprehet brenda 15 ditësh.

4. Rregullat e detajuara të paraqitjes, përzgjedhjes, verifikimit dhe testimit të kandidaturave caktohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 21

#### **Emërimi**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 8)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 10)*

1. Prokurori në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ky i fundit të ketë marrë mendimin e këshillit të prokurorisë.

2. Prokurori në prokurorinë pranë gjykatës për krime të rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë", për aftësi profesionale, dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Ndërmjet prokurorëve, që kandidojnë për në prokurorinë pranë gjykatës për krime të rënda dhe që plotësojnë kushtet e pikës 1 të këtij neni, këshilli i prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm përzgjedhin, sipas pikëve, kandidatin, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të nenit 43 të këtij ligji.

4. Presidenti, brenda 30 ditëve, dekreton emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Pas këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar.



## Neni 22

### **Betimi**

1. Para fillimit të detyrës, prokurorët bëjnë betimin si vijon:  
**“Betohelem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të ruaj të pastër figurën e prokurorit. Betohelem!”**
2. Betimi i prokurorëve të sapoemëruar bëhet në mënyrë ceremoniale përpara të gjithë prokurorëve të strukturës ku janë caktuar për kryerjen e detyrës.
3. Prokurori i Përgjithshëm cakton rregullat për procedurën e betimit.

## Neni 23

### **Prokurorët në stazh**

1. Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi.
2. Kriteret e përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “e” të nenit 17 të këtij ligji nuk përbëjnë pengesë për emërimin e personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni.
3. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekreton caktimin e tyre në prokuroritë sipas nevojave që kanë këto të fundit.

## Neni 24

### **Transferimi dhe ngritja në detyrë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 9)  
(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 11)*

1. Transferimi i prokurorit nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tij, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të prokurorisë. Transferimi i prokurorit mund të bëhet vetëm në të njëjtin nivel prokurorie. Kur, për nevoja të riorganizimit të prokurorisë, transferimi i prokurorit shoqërohet me ulje në nivel prokurorie, ai trajtohet me pagën që kishte.
2. Përrjashtim nga pika 1 e këtij neni përbën rasti kur jepet masë disiplinore “kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë”, parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji.
3. Ngritja në detyrë e prokurorit bëhet në bazë të kriterëve të njohura dhe objektive, si meritat dhe përvoja, të parashikuara në nenet 21 pikat 2 e 3 dhe 43 të këtij ligji.

## Neni 25

### **Komandimi**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 10)  
(Shtuar një fjali në fund të shkronjës “a” me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 12)*

- Prokurori i Përgjithshëm mund të komandojë prokurorë nga prokuroritë ku punojnë në prokurori të tjera:
- a) jo më shumë se katër muaj në vit, në rastet kur një prokurori nuk funksionon normalisht, për shkak të pamjaftueshmërisë së numrit të prokurorëve dhe të mbingarkesës së tyre; ky afat mund të zgjatet deri në tetë muaj, nëse prokurori i komanduar jep pëlqimin;
  - b) jo më shumë se kohëzgjatja e përfundimit të një procedimi penal të veçantë, kur paraqitet nevoja e kryerjes së hetimeve paraprake apo e gjykimit të tij.

## Neni 26

### **Pezullimi**

*(Shtuar pika 1/1 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 13)*

1. Prokurori mund të pezullohet në ushtrimin e detyrës me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm në këto raste:

- a) kur ndaj tij vendoset nisja e procedimit penal deri në përfundimin e procedimit;
- b) kur zbulohet një shkelje e rëndë disiplinore, derisa të plotësohet procedura e kërkuar për përgjegjësinë disiplinore, por jo më tepër se 30 ditë;
- c) kur Prokurori i Përgjithshëm i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e prokurorit nga detyra.

1/1. Prokurori pezullohet nga ushtrimi i detyrës, kur ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

2. Në rastin e pezullimit sipas pikës 1 të këtij neni, përkatësisht kur prokurori nuk gjendet fajtor nga gjykata ose nuk ka kryer shkelje disiplinore, ose ka kaluar afati prej 30 ditësh, i parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë të kthehet në detyrën e mëparshme.

3. Pezullimi i parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mbaron pas shqyrtimit nga Presidenti i Republikës të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 27

### **Largimi dhe shkarkimi nga detyra**

*(Ndryshuar shkronja “b” e pikës 1 dhe shkronja “b” e pikës 3 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 11)*

*(Ndryshuar shkronja “b” e pikës 3 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 14)*

1. Prokurori largohet nga detyra në këto raste:

- a) kur jep dorëheqjen;
- b) kur mbush moshën e pensionit;
- c) kur i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Prokurori i Përgjithshëm, pasi ka marrë pëlqimin e vetë prokurorit, mund të vendosë mbajtjen në detyrë të prokurorit që ka mbushur moshën për pension, të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni.

3. Prokurori shkarkohet nga detyra në këto raste:

- a) kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- b) kur merret masë disiplinore sipas shkronjave “c”, “d” dhe “dh” të nenit 32 të këtij ligji;
- c) kur është vlerësuar i paaftë në përputhje me pikat 3 e 4 të nenit 42 të këtij ligji.

Neni 27/a

### **Kushtet dhe emërimi i drejtuesit**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 15)*

1. Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe drejtuesi i hallkave të strukturës në Prokurorinë e Përgjithshme emërohen nga Prokurori i Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me dokumente.

2. Kandidatët për drejtues, sipas niveleve të prokurorisë, duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) të kenë punuar, si rregull, jo më pak se pesë vjet si prokurorë në prokurori të të njëjtit nivel ose të niveleve më të larta;
- b) të jenë vlerësuar “Shumë mirë” dy herët e fundit;
- c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- ç) të kenë aftësi organizuese dhe administruese.

Neni 27/b

**Largimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtuesit**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 15)*

1. Drejtuesit, sipas niveleve të prokurorisë, shkarkohen nga detyra e drejtuesit:
  - a) kur nuk përmbushin detyrat e parashikuara në nenin 27/c të këtij ligji;
  - b) në raste të shkarkimit të prokurorit, të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji.
2. Drejtuesi, sipas niveleve të prokurorisë, largohet nga detyra e drejtuesit kur:
  - a) jep dorëheqjen nga kjo detyrë;
  - b) janë raste të largimit të prokurorit, të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji;
  - c) është në pamundësi fizike të ushtrimit të detyrës, për më shumë se 3 muaj.
3. Largimi apo shkarkimi i drejtuesit nga detyra, sipas niveleve të prokurorisë, bëhet me urdhër të arsyetuar të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 27/c

**Kompetencat e drejtuesit**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 15)*

1. Drejtuesit, sipas niveleve të prokurorisë, përveç ushtrimit të funksioneve si prokuror më i lartë, kryejnë edhe këto detyra:
  - a) përfaqësojnë prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët në njësinë administrative, ku ushtron funksionet prokuroria;
  - b) bëjnë organizimin e punës në prokurori dhe ndarjen e prokurorëve, sipas njësave administrative ose drejtimeve, me grup veprash penale;
  - c) në fillim të çdo muaji, caktojnë listën e shërbimit të radhës në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe planifikojnë shpërndarjen e kallëzimeve/referimeve të ardhura në prokurori, sipas kriterëve të përcaktuara me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të parimeve të specializimit të prokurorëve dhe të ndarjes së barabartë të punës;
  - ç) organizojnë diskutime për çështje të natyrës juridike, në bazë të përgjithësimit të përvojës së ushtrimit të ndjekjes penale dhe të praktikës gjyqësore, të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, të vendimeve të Gjykatës Kushtetues dhe vendimeve të tjera gjyqësore në fushën penale, urdhrave, udhëzimeve dhe qarkoreve/porosive të Prokurorit të Përgjithshëm, akteve të kontrollit dhe inspektimeve të ushtruara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë;
  - d) mbikëqyrin respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbushin angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore;
  - dh) marrin kontakt me ekipet e inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë, njihen me qëllimin dhe objektin e inspektimit dhe u krijojnë atyre mundësi në ushtrimin e detyrës;
  - e) mbikëqyrin disiplinën në punë të prokurorëve;
  - ë) bashkërendojnë punën me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Shkollën e Magjistraturës, për çështje të ngritjes profesionale të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore;
  - f) kujdesen për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori;
  - g) kryejnë detyra të tjera, në funksion të drejtimit administrativ të prokurorisë, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi.
2. Kur drejtuesi mungon, detyrat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kryhen nga zëvendësdrejtuesi i autorizuar prej tij.

Neni 27/ç

**Regjistri i prokurorëve**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 15)*

Në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme krijohet regjistri i prokurorëve të prokurorive pranë gjykatës së shkallës së parë, të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, i cili përmban të paktën:

- a) gjenealogjet e çdo prokurori;
- b) të dhënat e edukimit të tij akademik;
- c) datën e emërimit;
- ç) pjesëmarrjen në kualifikime dhe trajnime;
- d) masat disiplinore, nëse ka;
- dh) vlerësimin e tij si prokuror;
- e) të dhëna për karrierën;
- ë) të dhëna në fushën e publikimeve.

**KREU VII**

**PROCEDIMI DISIPLINOR**

Neni 28

**Fillimi i procedimit**

*(Shfuqizuar pjesërisht pika 1 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 12)*

1. Fillimi i procedimit disiplinor bëhet nga Prokurori i Përgjithshëm.
2. Procedimi mbështetet në të dhënat e nxjerra nga inspektimi, për të cilin prokurori që procedohet është njoftuar paraprakisht. Procedimi fillon kur nga çasti i vënies re të shkeljes nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj dhe nga çasti i kryerjes së shkeljes nuk kanë kaluar më shumë se tre vjet.

Neni 29

**Njohja me dokumentacionin e procedimit**

1. Prokurorit të proceduar i jepet paraprakisht dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij, si dhe në afat jo më pak se 10 ditë për të përgatitur mbrojtjen.
2. Dita e shqyrtimit të materialeve i bëhet e njohur paraprakisht prokurorit të proceduar.

Neni 30

**E drejta për t'u dëgjuar**

*(Shtesë në pikën 1 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 16)*

1. Prokurori, në ngarkim të të cilit është nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet, duke u paraqitur vetë dhe/ose mbrojtësi i zgjedhur prej tij para Këshillit të Prokurorisë, i cili është i detyruar ta dëgjojë dhe të verifikojë pretendimet e ngritura.
2. Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme nuk e pengon Këshillin e Prokurorisë ta shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse.

Neni 31

**Shqyrtimi i mendimeve të Këshillit të Prokurorisë**

Për mendimet e dhëna nga Këshilli Prokurorisë për shkeljet disiplinore, Prokurori i Përgjithshëm shprehet brenda 15 ditëve nga paraqitja, duke arsyetuar qëndrimin e vet.

Neni 32

**Shkeljet disiplinore**

Quhen shkelje të disiplinës në punë:

- a) mospranimi i bërjes së betimit ose shkelja e tij;
- b) zvarritjet e rënda ose sistematike të procedimeve ose të detyrave të tjera të ngarkuara ose mospërbushja e detyrave;
- c) nxjerrja e sekretit të hetimit ose e të dhënave të tjera me karakter konfidencial;
- ç) mungesa për më shumë se pesë ditë pa arsye në punë;
- d) kryerja e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit;
- dh) kryerja e veprimeve që, sipas ligjit, janë të papajtueshme me funksionet e prokurorit.

Neni 33

**Masa disiplinore**

*(Riformuluar shkronja "c" e pikës "1" me ligjin nr.9102,  
datë 10.7.2003, neni13)*

1. Për shkelje të disiplinës ndaj prokurorëve merren këto masa:

- a) vërejtje;
- b) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra;
- c) kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë;
- ç) shkarkim nga detyra.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni jepen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm dhe shënohen në dosjen vetjake të prokurorit.

3. Shkarkimi nga detyra bëhet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Propozimi për shkarkim shoqërohet me kundërshtimet e prokurorit që procedohet disiplinarisht.

4. Masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni fshihen nga dosja kur kanë kaluar:

- a) tre muaj nga data që është dhënë masa sipas shkronjës "a";
- b) një vit nga data që është dhënë masa sipas shkronjës "b";
- c) një vit nga data që ka përfunduar masa e dhënë sipas shkronjës "c".

Neni 34

**Ankimi**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 14)  
(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 17)*

1. Kundër dhënies së masave disiplinore të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 33 të ligjit, prokurori mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa prokurorët pranë kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit më të afërt.

2. Kundër masës disiplinore "Shkarkim nga detyra", prokurori mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit, Tiranë, ndërsa prokurori pranë kësaj gjykate në gjykatën e apelit më të afërt. Kur gjykata çmon se shkarkimi nga detyra është i pabazuar në ligj, ajo vendos kthimin e tij në detyrë në prokurorinë pranë gjykatës ku ka qenë në momentin e fillimit të procedimit disiplinor dhe t'i japë prokurorit, nëse është e nevojshme, një shpërblim të drejtë. **Ketu ne ndryshimin e ri thuhet paragrafi i dyte**

KREU VIII

STATUSI DHE KARRIERA E PROKURORIT

Neni 35

**Mbrojtja e veçantë**

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 15)*

Prokurori ka të drejtë të ketë mbrojtje të veçantë vetjake, si dhe për familjen dhe pronën, kur një gjë e tillë paraqitet e nevojshme në rrethanat e një rreziku serioz të lidhur me ushtrimin e detyrës.

Prokurorëve, që e ushtrojnë detyrën pranë gjykatave të krimeve të rënda, u sigurohet i njëjti trajtim dhe e njëjta mbrojtje si gjyqtarëve të këtyre gjykatave.

Neni 36

### **Mbrojtja nga procesi penal**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 18)*

Neni 37

### **Trajtimi në rastet e cenimit të lirisë**

Në rastet kur prokurori ndalohet dhe ndaj tij është dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” ose është dënuar me burgim, ai qëndron në mjedise pa persona të tjerë, përveç rasteve kur ai vetë heq dorë me shkrim nga kjo e drejtë.

Neni 38

### **Pjesëmarrja në shoqata**

1. Prokurori është i lirë të marrë pjesë në shoqata ose organizata me veprimtari jofitimprurëse ose që kanë për qëllim respektimin e etikës ose ngritjen profesionale.

2. Prokurorit i ndalohet të bëjë grevë.

Neni 39

### **Papajtueshmëritë**

*(Shtesë në pikën 2 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 19)*

1. Prokurorit i ndalohet të bëjë pjesë në parti politike ose të marrë pjesë në veprimtari me karakter politik.

2. Funkzioni i prokurorit është i papajtueshëm me kandidimin dhe me çdo mandat zgjedhor, detyrë ose veprimtari publike, me përjashtim të veprimtarive edukative e të mësimdhënies e cila rregullohet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Prokurorit i ndalohet dypunësimi, me përjashtim të veprimtarive të lejuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Prokurorit i ndalohet të marrë pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare.

Neni 40

### **Ruajtja e të dhënave të procesit**

1. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë publike ose t’u japin personave të tretë të dhëna që mund të dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

2. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

Neni 41

### **Ngritja profesionale**

1. Prokurorët kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në trajnime periodike për ngritjen e nivelit të tyre profesional.

2. Prokurorët përfitojnë falas Fletoren Zyrtare dhe literaturë tjetër juridike.

Neni 42

**Vlerësimi i punës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 20)*

1. Vlerësimi i punës së prokurorit bëhet për aftësitë profesionale dhe personale, aftësitë dhe qëndrimin shoqëror, aftësitë administruese, si dhe për respektimin e disiplinës në punë dhe masat disiplinore.

2. Vlerësimi paraprak i punës së prokurorit bëhet nga drejtuesi i prokurorisë. Ky vlerësim shërben si propozim për vlerësimin final të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, që mund të zëvendësojë vlerësimin paraprak, për shkak të një krahasimi të drejtë, në shkallë vendi, të vlerësimeve.

3. Për vlerësimin e punës të prokurorit, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore kryen inspektimin e planifikuar, jo më pak se një herë në tre vjet.

4. Këshilli i prokurorisë shqyrton vlerësimin paraprak të punës dhe ia paraqet mendimin e vet Prokurorit të Përgjithshëm, i cili duhet të shprehet brenda 15 ditëve.

5. Në rastet kur një prokuror bën kërkesë për ngritje në detyrë, transferim ose në një pozicion tjetër, duhet të bëhet një vlerësim i ri, përveç kur vlerësimi i fundit është bërë brenda gjashtë muajve të fundit. Prokurori duhet të njihet me vlerësimin që i është bërë.

6. Vlerësimi i punës së prokurorit është:

- a) “Shumë mirë”;
- b) “Mirë”;
- c) “Mjaftueshëm”;
- ç) “I paaftë”.

7. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës, për shkarkimin nga detyra të prokurorit.

8. Në rastet kur prokurori është vlerësuar “Mjaftueshëm”, brenda një viti, bëhet rivlerësimi i tij.

9. Për efekt të karrierës profesionale, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme mban një listë të përhershme të renditjes së prokurorëve për rezultatet e punës, e cila përditësohet në vijimësi.

10. Rregullat për vlerësimin e punës së prokurorit dhe për kriteret e renditjes së prokurorëve në listën e përhershme përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi të ketë marrë mendimin e këshillit të prokurorisë.

Neni 43

**Ngritja në detyrë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 21)*

1. Prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me dokumente, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në prokurorinë pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë”, për vlerësimin e punës, dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

2. Prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me dokumente, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në prokurorinë pranë gjykatave të apelit ose 12 vjet në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë”, për vlerësimin e punës, dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Kur konkurrojnë dy ose më shumë kandidatë për në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në Prokurorinë e Përgjithshme, që plotësojnë kushtet e pikave 1 e 2 të këtij neni, këshilli i prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm përzgjedhin, sipas pikëve, kandidatin me më tepër përvojë/vjetërsi në profesion,

me më tepër merita/rezultate në punë në vijimësi, si dhe me më tepër veprimtari shkencore/akademike. Rregulla më të hollësishme për pikëzimin përcaktohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Presidenti, brenda 30 ditëve, dekreton emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Me kalimin e këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar.

Neni 44

#### **Ruajtja e statusit të prokurorit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 22)*

1. Prokurorët, me kërkesën e institucioneve dhe me pëlqimin e tyre, mund të shërbejnë për një afat deri në katër vjet në strukturat juridiko-profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, të Ministrisë së Drejtësisë, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në mbarim të këtij afati, me kërkesën e tyre, ata rrimërohen prokurorë, pa konkurs, në vendin që kanë pasur.

2. Trajtimi financiar i prokurorit bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si prokuror, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.

Neni 45

#### **Dokumenti i identifikimit**

Prokurori pajiset me dokument identifikimi. Forma dhe përmbajtja e dokumentit përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 46

#### **Pajisja me armë**

Prokurori ka të drejtë të mbajë armë vetjake, me të cilën pajiset sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 47

#### **Strehimi**

1. Prokurori ka të drejtë të përfitojë banesë me kredi me kushte lehtësuese kur nuk ka banesë ose sipërfaqe të banueshme banimi në rrethin ku punon.

2. Në rast se prokurori ka banesë në një rreth tjetër nga ai ku ushtron detyrën, ai përfiton sipas pikës 1 të këtij neni, por shuma e kredisë do të jetë sa diferenca ndërmjet vlerës së kredisë për banesën e re me vlerën e banesës që ka në pronësi.

3. Fondet për strehim parashikohen në buxhetin vjetor të Prokurorisë.

Neni 48

#### **Shpenzimet e transferimit**

1. Prokurori gëzon të drejtën e paradhënies ose të rimbursimit të plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe të familjes, si dhe të transportit të orendive shtepiake, kur ai ngrihet në detyrë ose transferohet në një rreth tjetër për shkaqe që nuk lidhen me masa disiplinore.

2. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë kur transferohet me kërkesën e vet.

Neni 49

#### **Koha e punës**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 16)*



1. Koha javore e punës dhe orarit, si rregull, janë të njëjta me ato të gjykatave.
2. Në rast nevoje, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, prokurori është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit, në ditët e pushimit javor, të festave ose kur është duke kryer lejen vjetore.
3. Titullarët e çdo strukture të Prokurorisë organizojnë shërbimin e radhës për ditët e javës, të fundit të javës dhe të festave. Lista e shërbimit caktohet çdo muaj. Për ditët e parashikuara në listën e shërbimit të radhës, prokurorët detyrohen të lënë adresën e saktë të vendndodhjes së tyre.

Neni 50

#### **Leja vjetore**

*(Ndryshuar pka 1 dhe 2 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 23)*

1. Prokurori gëzon të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore, si rregull, bëhet në muajin gusht.
2. Në rastet kur prokurori ngarkohet me kryerjen e detyrave të ngutshme muajin gusht, si dhe kur ndërpret lejen për nevoja pune, përveç ditëve të pushimit të mbetura, përfiton deri në pesë ditë pushimi shtesë.
3. Prokurorët kur largohen me leje vjetore detyrohen të lenë adresën e saktë të vendit ku do të kryejnë pushimet dhe ditët e qëndrimit atje.

Neni 51

#### **Leja për raste të veçanta**

*(Shtuar pika 3 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 24)*

1. Për nevoja të veçanta, vetjake ose familjare, prokurori ka të drejtë të përfitojë leje të papaguar deri 20 ditë në muaj, por jo më tepër se 30 ditë në vit.
2. Në raste martesash ose vdekjesh brenda familjes, kur është konsumuar koha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, prokurori ka të drejtë të përfitojë deri në 10 ditë leje.
3. Për nevoja të kualifikimeve dhe të specializimeve profesionale prokurori ka të drejtë të kërkojë leje të papagueshme dhe ruajtjen e vendit të punës deri në një vit.

Neni 52

#### **Paga, shpërblimet dhe trajtimet**

*(Ndryshuar pjesërisht pika 5 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 17)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 25)*

1. Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.
2. Paga e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme është e barabartë me pagën e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e drejtuesve të hallkave, që janë prokurorë në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme, është 5 për qind me e lartë se paga e prokurorëve të kësaj prokurorie.
3. Paga bazë e prokurorit ose drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe shtesa për vjetërsi apo vështirësi në shërbim e tyre, është e barabartë me pagën dhe shtesën e vjetërsisë dhe të vështirësisë së gjyqtarit e të kryetarit të gjykatës, pranë së cilës funksionon prokuroria, ku ai është emëruar.
4. Në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, prokurori i gatshëm ose prokurori, që kryen detyra të ngutshme përfiton shtesë page, në masën 50 për qind të pagës së tij ditore.
5. Prokurori mund të përfitojë shpërblime, për merita profesionale, në masën e caktuar, me propozimin e drejtuesit dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm.
6. Prokurori, me propozimin e eprorit dhe me miratimin e prokurorit të Përgjithshëm, mund të përfitojë deri në 20 për qind shtesë page për vështirësi pune.

7. Prokurorët dhe drejtuesit e tyre kanë të njëjtat trajtime dhe status protokollar si gjyqtarët dhe drejtuesit e gjykatave, pranë të cilave ushtrojnë funksionet prokuroria, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.

## KREU IX MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 53

### **Marrëdhëniet me Kuvendin**

*(Ndryshime në pikën 1 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 26)*

1. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvend ose komisionet parlamentare të paktën një herë në gjashtë muaj ose sa herë që kërkohet prej tyre. Raportimi përmban të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe drejtimit dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit.

2. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit.

3. Kuvendi mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm sugjerime për rregullimin ligjor të çështjeve të ndryshme.

4. Prokurori i Përgjithshëm bashkëpunon me komisionet e hetimeve parlamentare sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 54

### **Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave**

*(Shtuar pika 4 me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 18)*

1. Çdo vit, jo më vonë se data 31 mars, Ministri i Drejtësisë, në emër të Këshillit të Ministrave, i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet që duhet të mbahen parasysh për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.

2. Prokurori i Përgjithshëm ua bën të njohura rekomandimet e Këshillit të Ministrave drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët, ku merr pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, jo më vonë se muaji prill. Rekomandimet e analizuara në mbledhje bëhen publike.

3. Në marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm me Këshillin e Ministrave ndalohen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.

4. Nga të ardhurat që kanë kaluar në favor të shtetit, si rezultat i sequestrimit të provave materiale në përfundim të një procedimi penal, Këshilli i Ministrave përcakton pjesën që i kalon Prokurorisë për t'u përdorur për mjete logjistike dhe për shpërblimin e prokurorëve.

Neni 55

### **Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Drejtësisë**

*(Shtuar një fjali në fund të pikes 1 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 27)*

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm që, në bazë të të dhënave të dala nga mbledhjet e tij dhe që implikojnë prokurorët, të nisë procedimin disiplinor. Prokurori i Përgjithshëm shqyrton rekomandimin dhe vendos në lidhje me të.

2. Prokurori i Përgjithshëm mund t'i drejtohet Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të kërkuar çdo material përgjithsues për gjendjen e procedimeve penale në gjykata, problemet e ndjekjes penale ose për çështjet organizative e strukturore që lidhen me prokurorinë.

Neni 56

### **Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë**

*(Shtuar një fjali në fund të pikes 4 dhe pika 5 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 28)*

1. Ministri i Drejtësisë kontrollon në mënyrë të planifikuar ose në bazë të informacioneve të dhëna nga organe, institucione ose persona të interesuar, ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve.

2. Objekti i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë në organin e prokurorisë është:

a) ndjekja e ecurisë së çështjeve që përmbahen në rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit;

b) respektimi i afateve të hetimit;

c) respektimi i afateve të paraburgimit;

ç) respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të subjekteve të procedimit penal dhe, në veçanti, të të ndaluarve dhe të arrestuarve;

d) rregullshmëria dhe vijueshmëria e kryerjes të veprimeve hetimore;

dh) respektimi i detyrimit ligjor të prokurorit për fillimin e ndjekjes penale;

e) ecuria e politikës penale dhe, në veçanti, e politikës së dënimeve që ndiqet nga prokurorët;

ë) rregullshmëria e mbajtjes dhe administrimit të statistikave dhe regjistrimit të veprave penale;

f) respektimi i parimeve të drejtësisë, barazisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit në marrëdhëniet e tij me subjektet e tjera të procedimit penal.

3. Kontrolli në çdo rast duhet të jetë i paralajmëruar dhe për çështje për të cilat kanë përfunduar hetimet paraprake.

4. Për rezultatin e kontrollit vihet në dijeni Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori, veprimtaria e të cilit ka qenë objekt kontrolli. Ministri i Drejtësisë paraqet në Kuvend, të paktën një herë në vit, raport me shkrim për inspektimet e kryera nga Ministria e Drejtësisë, duke vënë në dijeni edhe Prokurorin e Përgjithshëm. Raporti përmban të dhëna të përgjithshme për çështjet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të paraqesë në Kuvend mendimin e tij për raportin e dërguar nga Ministri i Drejtësisë, sipas kësaj pike.

5. Në bazë të rezultateve të kontrollit, Ministri i Drejtësisë, kur është rasti, paraqet rekomandim, për nisjen e procedimit disiplinor, Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm shqyrton rekomandimin dhe vendos në lidhje me të. Rekomandimi për nisjen e procedimit disiplinor dhe përgjigjja e Prokurorit të Përgjithshëm i njoftohen Presidentit të Republikës.

Neni 56/a

### **Marrëdhëniet me policinë gjyqësore**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 29)*

1. Prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të policisë gjyqësore, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

2. Prokurori ka të drejtë:

a) t'i japë urdhra dhe udhëzimet e duhura policisë gjyqësore për:

i) zbatimin efikas të përparësive të politikës penale;

ii) përcaktimin e kategorive të çështjeve që kanë përparësi dhe mjeteve të përdorura për kërkimin e provës;

iii) kohëzgjatjen e hetimeve, si dhe për t'u informuar në vazhdimësi për ecurinë e hetimeve;

b) t'i caktojë çështje të veçanta strukturave të policisë gjyqësore, sipas juridiksionit dhe llojit të çështjes, si dhe mundësive që ata kanë në kryerjen e hetimeve;

c) të bëjë vlerësime dhe kontrole, për aq kohë sa është e nevojshme, për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit dhe të urdhrave e udhëzimeve të tij;

ç) të kërkojë fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masave disiplinore për shkelje të ligjit nga policia gjyqësore.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 57

**Buxheti**

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 19)*

*(Hiqen fjalë në pikën 2 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 30)*

Prokuroria ka buxhet të pavarur që hartohet, administrohet e zbatohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Prokurori i Përgjithshëm mund të emërojë kancelarë për ndjekjen e problemeve të karakterit administrativ e financiar. Paga e tyre është e njëjtë me atë të kancelarëve pranë gjykatave.

Neni 58

**Nëpunësit**

*(Riformuluar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003, neni 20)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 31)*

1. Sekretari i përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Shërbimet e tjera tekniko-administrative në Prokurorinë e Përgjithshme dhe shërbimet ndihmëse në prokuroritë e niveleve të tjera, pranë sistemit gjyqësor, kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë.
3. Sekretari i përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive të niveleve të tjera, nën autoritetin e Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Punonjësit e administratës së Prokurorisë së Përgjithshme u nënshtrohen rregullave të shërbimit civil. Marrëdhëniet e punës të personelit administrativo-teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
5. Trajtimi financiar i administratës së prokurorive të niveleve të tjera, pranë sistemit gjyqësor, barazohet me punonjësit e administratës të sistemit gjyqësor, pranë së cilës funksionon prokuroria.

Neni 58/a

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 32)*

Në nenet 3, 9, 13 e në vijim të ligjit, fjalët “Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm” zëvendësohen me fjalët “Prokuroria e Përgjithshme”.

Neni 58/b

**Dispozitë kalimtare**

*(Shtuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 32)*

Deri në fillimin e funksionimit të sistemit të vlerësimit të punës së prokurorit dhe kryerjen e vlerësimit dy herë, për efekt të ngritjes në detyrë dhe të karrierës, Prokurori i Përgjithshëm cakton procedura dhe kritere specifike për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve.

Neni 59

**Nxjerrja e akteve nënligjore**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008, neni 33)*

1. Çështjet e parashikuara në nenet 9 pikat 2 e 3, 10 pika 4, 12, 13, 14, 15, 20 pika 4, 22 pika 3, 27/c pika 1 shkronja “c”, 39 pika 2, 40, 41, 42 pika 10, 43 pika 3, 45, 49, 50, 51 e 58/b të këtij ligji rregullohen me akte nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Çështjet e parashikuara në nenet 5 dhe 37 të këtij ligji rregullohen me akte të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Drejtësisë.
3. Çështjet e parashikuara në nenet 35 dhe 46 të këtij ligji rregullohen me akte të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik.

Neni 60  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ligji nr.8737, datë 12.2.2001 shpallur me dekretin nr.2908, datë 27.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 139

Ligji nr.9102, datë 10.7.2003 shpallur me dekretin nr.3905, datë 25.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.62, faqe 2081

Ligji nr.10 051, datë 29.12.2008 shpallur me dekretin nr.6009, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.205, faqe 10054